

Pjesëmarrja efiçente

Manual mbi angazhimin dhe pjesëmarrjen në krijimin e politikave publike për Efiçencën e Energjisë



Impresum

Autorët: Ky manual bazohet mbi broshurën e përgatitur nga projekti CENEP dhe është plotësuar më tej nga ekipet e projekteve STRONG SEE (Forcimi i rolit të OJF-ve në dialogun publik për mbrojtjen e klimës në Evropën Juglindore) dhe projekti PDI (Dialogu publik mbi përdorimin e qëndrueshëm të energjisë në Evropën Juglindore).

Përktheu: Akademia e Studimeve Politike (ASP)

Përpunimi grafik: BEF Germany

Viti i botimit: 2015

Ky manual u zhvillua si projekt i Strong SEE. Projekti është i financuar nga STRONG DBU (Deutsche Bundesstiftung Umwelt). Përmbajtja e këtij publikumi është reflektim i autorit dhe nuk ka të bëjë me pikëpamjet e DBU.

Sponsored by



Deutsche Bundesstiftung Umwelt

www.dbu.de

Partnerët e programit "Dialogu Publik për Përdorimin e Qëndrueshëm të Energjisë në Evropën Jug-Lindore" (PDI) u mbështetën financiarisht nga Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman (GIZ)




Implemented by



Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



Përmbajtja



1. Hyrje	4
1.1. Përse është e nevojshme përfshirja e publikut?	4
1.2. Nivelet e pjesëmarrjes publike	5
2. Këshilla dhe rekomandime	7
2.1. Këshilla dhe rekomandime për autoritetet publike	7
2.2. Këshilla dhe rekomandime për autoritetet vendore	11
2.3. Këshilla dhe rekomandime për organizatat e shoqërisë civile	15

1. Hyrje

Politikat publike në lidhje me Efiçencën e Energjisë nuk kanë qënë deri më sot tema e diskutimeve dhe shqetësimeve të publikut të gjerë. Diskutimet rreth kësaj teme janë përgjithësisht të limituara midis një rrethi të ngushtë institucionesh evropiane dhe kombëtare, ekspertëve dhe një numri të vogël të organizatave të shoqërisë civile të interesuara (OJF).

Ky manual përpiqet të sjellë një përmbledhje të ideve, rekomandimeve dhe eksperiencave të OJF-ve nga Evropa Juglindore, të fokusuara mbi politikat publike të Efiçencës së Energjisë. Ai përbën gjithashtu një prezantim të metodave të ndjekura, nëpërmjet të cilave janë arritur rezultate të sigurta. Materiali ofron shembuj konkretë dhe sugjerime të vlefshme për të nxitur dhe organizuar dialogun publik në këtë fushë.

Në mënyrë që të jetë sa më i qartë, manuali është ndarë në kapituj të veçantë, të cilët u drejtohen autoriteteve qendrore, atyre vendore si dhe organizatave të shoqërisë civile. Pavarësisht kësaj, autorët këshillojnë përfaqësuesit e secilit prej këtyre grupeve që të lexojnë gjithashtu rekomandimet drejtuar grupeve të tjera pjesëmarrëse. Aftësia për të kuptuar pritshmëritë e palës tjetër ndërvepruese është një domosdoshmeri e një dialogu sa më të civilizuar, krijues dhe të strukturuar ndërmjet aktorëve të ndryshëm, duke përfaqësuar në këtë mënyrë një nga bazat e një shoqërie aktive dhe demokratike.

1.1. Përse është e nevojshme përfshirja e publikut?

Shoqëria civile përfaqëson hapësirën midis familjes, shtetit dhe tregut, në të cilën qytetarët bashkohen në mënyrë që të artikulojnë dhe promovojnë interesat e përbashkëta. Organizatat e shoqërisë civile karakterizohen si jofitimprurëse të pavarura nga qeveria dhe përfshijnë shoqata, unione, fondacione dhe organizata fetare.

Një nga karakteristikat bazë të demokracive moderne është një shoqëri civile e zhvilluar. Roli aktiv i qytetarëve në njërin anë dhe transparenca e institucioneve publike në tjetrën sigurojnë një dialog të hapur, bashkëpunim dhe partneritet. Zhvillimi i këtij bashkëpunimi dhe partneriteti të qëndrueshëm, si dhe zhvillimi i shoqërisë në përgjithësi është i siguruar nëpërmjet respektit për të drejtat njerëzore dhe pjesëmarrjes së barabartë të femrave dhe meshkujve, një tjetër aspekt thelbësor i demokracisë. Si pasojë, njohja e rolit të rëndësishëm të pjesëmarrjes së publikut, duke përfshirë dhe pjesëmarrjen e grupeve të marginalizuara, është përfshirë që nga viti 2003 nga Komisioni Evropian në udhëzuesin e "kriterëve të përgjithshme dhe standarteve minimale

të konsultimit të grupeve të interesuara”.¹

Në përmbajtjen e këtij materiali të rëndësishëm, theksohet se “nëpërmjet krijimit të një procesi konsultimi, Komisioni Evropian nxit përfshirjen e grupeve të tjera të interesuara në zhvillimin e politikave evropiane. Fillimi i kësaj konsulte në fazat e hershme në procedurën e hartimit të ligjeve, ndihmon në përmirësimin e efektivitetit të politikave, ndërkohë që forcon përfshirjen e grupeve të interesuara dhe publikut.” Roli specifik i OJF-ve shprehet gjithashtu “Organizatata e shoqërisë civile qendrojnë si urë lidhëse midis qytetarëve dhe institucioneve evropiane duke nxitur kështu politikën e dialogut dhe pjesëmarrjen aktive të qytetareve në arritjen e qëllimeve të Bashkimit Evropian.”

Një dokument tjetër i rëndësishëm është Kodi i praktikës së mirë për pjesëmarrjen civile në procesin e vendimmarrjes, i cili u mbështet nga Komiteti i Ministrave në një deklaratë në të cilën “njihet rëndësia e Kodit të praktikës së mirë si një dokument referues për Këshillin e Evropës dhe një bazë për fuqizimin e qytetarëve që të përshihen në zbatimin e çështjeve publike në Evropë.”

Legjislacioni i vendeve të Evropës Juglindore mbështet strategjinë e BE-së dhe inkurajon përfshirjen e OJF-të në proceset e vendimmarrjes.² Në Shqipëri nuk ekziston një legjislacion apo rregullore përkatëse, por konsultimet me grupet e ndryshme të interesit në procesin e hartimit të politikave të ndjeshme për publikun, janë një praktikë e zakonshme dhe e përdorur gjerësisht.

Qëllimi kryesor i konsultimeve dhe përfshirja e të gjithë aktorëve të interesuar në proces, është sigurimi i informacioneve mbi interesat, opinionet dhe rekomandimet e tyre rreth një politike publike të caktuar. Në këtë mënyrë rritet niveli i mirëkuptimit dhe pranimit të objektivit të këtyre politikave dhe gjithashtu u paraprihet pasojave negative të mundshme të një politike publike, të cilat mund të eliminohet në kohën e duhur.

1.2. Nivelet e pjesëmarrjes publike

Pjesëmarrja publike mund të shtrihet në pesë nivele:

1. Informimi
2. Konsultimi

¹ Drejt forcimit të kulturës së konsultimit dhe dialogut - Kriteret dhe standartet e detyrueshme të Komisionit Evropian për konsultimet me grupet e interesit - <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX:52002DC0704>

² Kodi i praktikës së mirë për pjesëmarrjen civile në procesin e vendimmarrjes - http://www.coe.int/t/ngo/Code_good_prac_en.asp

3. Përfshirja
4. Bashkëpunimi
5. Fuqizimi

Secila prej këtyre fazave lidhet me:

- » qëllime të caktuara që mund të arrihen nëpërmjet pjesëmarrjes publike,
- » bashkëpunimi i vendimmarrësve me publikun,
- » metodat nëpërmjet të cilave kjo pjesëmarrje do të bëhet e mundur (Tabela 1).

	Informimi	Konsultimi	Përfshirja	Bashkëpunimi	Fuqizimi
Objekti i pjesëmarrjes së publikut	I siguron publikut informacion të balancuar dhe objektiv. I mundëson atij kuptimin e problematikës, mundësive dhe zgjidhjeve	Mundëson marrjen e reagimit të publikut ndaj analizave, alternativat dhe vendimet	Siguron bashkëpunim direkt me publikun duke bërë të mundur kuptimin dhe konsiderimin e shqetësimeve dhe pritshmëri-ve të publikut	Mundëson partneritetin me publikun në çdo aspekt të vendim-marrjes duke përfshirë edhe gjetjen e alternativave dhe zgjidhjeve të përshatshme	E bën publikun të ndjehet pjesë e vendim-marrjes finale
Premimet ndaj publikut	Do t'iu informojmë në vazhdim	Do t'iu informojmë në vazhdim, t'iu dëgjojmë dhe vlerësojmë shqetësimet dhe sugjerimet tuaja si dhe sigurojmë informim se si janë marrë në konsideratë	Do të punojmë me çdokënd prej jush për të siguruar që shqetësimet dhe sugjerimet tuaja janë pasqyruar në zhvillimin e alternativave si dhe sigurojmë informim se si janë marrë në konsideratë	Presim që ju të keshiloni dhe formuloni zgjidhjet e mundshme si dhe do t'i përfshijmë ato në maksimumin e mundshëm në rekomandimet e vendim-marrjes	Do të zbatojmë vendimin tuaj
Shembuj teknikash	Publikime - Website - Zyra informimi	Opinionet e publikut - Grupe fokusi - Sondazhe - Takime publike	Takime pune - Sondazh direkt	Komitete këshillimore qytetarësh - Ndërtimi i konsensusit - Vendim-marrje me pjesëmarrje	Juri qytetarësh - Votim - Vendime të deleguara

Tabela 1: Rritja e nivelit të ndikimit publik (Izvor tablice: http://c.ymcdn.com/sites/www.iap2.org/resource/resmgr/imported/IAP2%20Spectrum_vertical.pdf)

Bashkëpunimi përfaqëson një formë shumë të larte dhe të dëshirueshëm të pjesëmarrjes publike, por një arritje e tillë nuk varet vetëm nga gatishmëria për bashkëpunim e autoriteteve publike, por gjithashtu edhe nga interesi dhe kapaciteti i ekspertizave të publikut të interesuar si dhe nga ekzistenca e kulturës të komunikimit dhe bashkëpunimit në një shoqëri. Arritja e një niveli të tillë bashkëpunimi është përgjegjësia dhe sfida e të gjitha palëve pjesëmarrëse në proces si dhe një inkurajim drejt një zhvillimi të mëtejshëm të kapaciteteve, gatishmërisë dhe mundësive për bashkëpunim si dhe një dialogu sa me të dobishëm.

2. Këshilla dhe rekomandime

2.1. Këshilla dhe rekomandime për autoritetet publike

Autoritetet publike shtetërore janë përgjegjëse dhe drejtuese të politikave publike. Procesi ideal i politikave publike është një procedure e vazhdueshme e krijimit, implementimit dhe monitorimit të impakteve të politikave si dhe korigjimi i tyre në rast se dështohet në arritjen e qëllimit të caktuar ose në rast se nevojitet përmirësimi i tyre. (Figura 1).

Transparenca e procedurës dhe gjithëpërfshirja e një rrethi të gjerë aktorësh në secilin prej hapave të procesit janë jetike për pranimin e politikave dhe suksesit të tyre. Gjatë përfshirjes në krijimin e politikave publike pjesëmarrësit fitojnë një ndjenjë pronësie mbi të dhe si rrjedhojë janë më të përkushtuar në zbatimin e saj.

Më poshtë mund të gjeni disa këshilla drejtuar vendimmarrësve autoritete publike mbi përmirësimin e procedurave të krijimit të politikave publike.

Shembull

Një nga shembujt më të njohur se çfarë mund të ndodhë në rast se mungon transparenca dhe përfshirja e publikut në vendimmarrjen e institucioneve publike është çështja e shkatërrimit të armëve kimike siriane në territorin shqiptar. Për shkak se qeveria shqiptare nuk përfshiu në këtë diskutim shoqërinë civile dhe ekspertët e pavarur, u krijua një panik i panevojshëm që çoi në protesta publike dhe tërheqjen nga ky propozim përpara se të vlerësoheshin përfitimet dhe pasojat që mund të kishte.



Figura 1. Procesi i politikave publike

Këshilla dhe rekomandime për krijimin e një politike publike të re:

1. Përcaktoni qartësisht arsyet për të cilat po krijohet politika publike:
 - » Përputhja me legjisllacionin e BE-së nuk mjafton si një arsye e mirë e pranueshme për krijimin e një politike të re - Një politikë publike duhet të synojë drejt interesit dhe mirëqënies së përgjithshme. Kjo duhet të jete artikuluar qartë;
 - » Komunikoni sa më qartë me publikun rreth arsyeve për këtë politikë
2. Vlerësoni burimet tuaja (personelin e disponueshëm, financat dhe kohën) dhe kompetencat e nevojshme për krijimin e politikës së re publike:
 - » Përmirësoni njohuritë tuaja rreth temës nëpërmjet analizave të detajuara të shembujve nga vende të tjera
 - » Nëse nevojitet, punësoni ekspertë të jashtëm për të prodhuar

analiza profesionale;

- » Kërkoni që çdo analizë të përmbajë rekomandime të bazuara në faktorë të ndryshëm dhe me zgjidhje të ndryshme të mundshme.

3. Sigurohuni që zgjedhjet tuaja të bazohen në bashkëpunimin me aktorët e përfshirë në politikë:

- » Konsultohuni me aktorët në mënyrë direkte ose indirekte;
- » Formoni një grup pune (ose disa grupe) i cili nën udhëheqjen tuaj të rekomandojë, analizojë dhe përshtasë zgjidhje të mundshme nëpërmjet të cilave do të arrihen qëllimet:

I. grupet e punës gjithmonë duhet të përfshijnë ekspertë nga fusha e caktuar, përfaqësues të organeve shtetërore, por dhe shoqëri civile, unione dhe sektorin e biznesit. Një avantazh i rëndësishëm do ishte përfshirja e eksperteve të barazisë gjinore;

II. menaxhoni diskutimet e grupit të punës dhe përpiquni të mbyllni takimet me konsensus.

- » Komunikoni me publikun rreth zgjidhjeve ndërkohë që kujdeseni për nevojat e ndryshme të komunikimit dhe mënyrat e duhura të komunikimit drejtuar grupeve specifike si gratë, burrat, të rinjtë, të moshuarit etj.

4. Përpunoni çdo instrument të politikës me detaje duke patur parasysh ecurinë e saj në çdo detaj:

- » përcaktoni cili institucion është përgjegjës për zbatimin e instrumentave përkatës të politikës- shmangni mbivendosjet e përgjegjësive ose ndarjen e paqartë të detyrave;
- » vlerësoni burimet financiare të nevojshme dhe burimet nga mund të përfitohen ato;
- » përcaktoni rezultatet që priten nga politika dhe kontributin e saj për arritjen e objektivave të përgjithshme;
- » informoni publikun rreth instrumenteve të politikës.

5. Siguroni një diskutim publik të bazuar mbi një version paraprak (draft) të politikës së re.

- » megjithëse mund të jetë i dobishëm, ndërmarrja e një diskutimi publik vetëm nëpërmjet faqes së internetit të institucionit nuk është i mjaftueshëm;
- » diskutoni propozimet për politikën duke marrë pjesë në aktivitete

publike – përgjigjuni ftesave dhe përgatituni që t'i jepni përgjigje çdo pyetje apo diskutimi ndaj propozimeve alternative. Ky është një detyrim për ju;

- » qëndroni një hap përpara medias - mos lejoni hamendësitë rreth politikave të reja, përdoreni median për të informuar publikun duke dhënë njoftime të qarta dhe të sakta.
- » krijoni një mekanizëm që lejon transmetimin e shqetësimeve të aktorëve dhe publikut dhe siguroni një mënyrë për t'i dëshmuar atyre se këto shqetësime janë marrë parasysh. Të dhëna për përfshirjen gjinore duhet të sigurohen kurdoherë.

6. Miratojeni politikën zyrtarisht dhe brenda kohës së përcaktuar.

Shembull:

Ministria e Energjisë dhe Industrisë arriti të përfshinte një numër të madh aktorësh gjatë hartimit të ligjit të ri të energjisë elektrike. Në shtatorin e vitit 2014, kjo ministri nisi konsultimet me grupet e interesit duke prezantuar draftin paraprak të projektligjit dhe duke kërkuar rekomandimet përkatëse nga të gjithë aktorët. Një nga pikat e ndryshuara të projektit pas këtyre diskutimeve ishte heqja e barrës hipotekore për konsumatorët familjarë që janë debitorë ndaj OSHEE-së. Në muajin Prill 2015 (pas tetë muajsh diskutimi) ligji u miratua me shumicë të kënaqshme votash në Kuvend dhe pa shkaktuar reagim negativ të grupeve të interesit.

Këshilla dhe rekomandime për zbatimin e politikës

1. Përcaktoni qartësisht se cilat institucione janë përgjegjëse për zbatimin, duke patur parasysh kapacitetet e çdo institucioni.
2. Komunikoni dhe bashkëpunoni me autoritetet rajonale dhe vendore dhe aktorët e tjerë të përfshirë në zbatimin e politikës:
 - » Lajmërojini ata rreth detyrimeve të tyre;
 - » Pajisini ata me ekspertizë në përmbushjen e detyrimeve të tyre;
 - » Kërkoni një informim të vazhdueshëm rreth ecurisë së zbatimit të politikës.
3. Informohuni mbi praktikatat e tjera pozitive:
 - » siguroni shembuj të suksesshem dhe paraprijeni zbatimin e tyre.

Këshilla dhe rekomandime për mbikqyrjen dhe vlerësimin e politikës

1. Ndërsa pasoja e një politike është në proces e sipër, duhen përcaktuar metodat e monitorimit të ndikimit që do të ketë ajo; metodat e impaktit politik duhet të përmbajnë perspektivën e barazisë gjinore duke siguruar konsiderimin e ndikimit përkatës që mund të ketë politika tek gjinitë e ndryshme.
2. Ndërsa një politikë është në proces e sipër, matni ndikimet e mundshme të pasojave dhe krahasojini ato me të dhënat e përftuara nëpërmjet raportimeve gjatë zbatimit të saj.
3. Angazhohjini të gjithë aktorët përgjegjës për zbatimin e një mase të caktuar, që të raportojnë mbi zbatimin dhe ndikimin e saj në një mënyrë të rregullt:
 - » informojini aktorët rreth detyrimeve të tyre dhe kërkoni të informoheni rreth gjendjes rregullisht;
 - » përcaktoni të dhënat e sakta që duhet të raportojnë aktorët si dhe mënyren si do e bëjnë këtë.

2.2. Këshilla dhe rekomandime për autoritetet vendore

Funksionet dhe detyrat e autoriteteve vendore janë të lidhura drejtpërdrejtë me shërbimet që u ofrohen qytetarëve. Në sektorin e energjisë, vendorët duhet të planifikojnë nevojat dhe mënyrat e furnizimit me energji, të krijojnë planet zhvillimore urbane, mirëmbajnë dhe përdorin strukturat e furnizimit të energjisë si dhe të krijojnë programe për një përdorim eficient të energjisë në nivel vendor.

Autoritetet vendore duhet të mundësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në çështjet publike në drejtim të zbatimit të politikave publike, duhet të vendosin parimet e përgjegjësive, transparencës, eficientës dhe përfaqësimit e barabartë gjinor. Zbatimi i politikave publike në shkallë vendore mund të përmirësohet duke zmadhuar bashkëpunimin horizontal dhe vertikal duke forcuar kështu kapacitetin për zbatimin.

Këshilla dhe rekomandime për krijimin dhe zbatimin e një programi vendor për përdorimin eficient të energjisë

1. Forconi kapacitetet tuaja institucionale:
 - » përcaktoni dhe edukoni personat përgjegjës duke u kujdesur për përfaqësimin e barabartë gjinor si dhe grupeve të marginalizuara duke siguruar të paktën 40% të tyre; i njëjti parim duhet zbatuar

edhe në përfshirjen e ekspertëve.

- » siguron fondet fillestare për zhvillimin e programit dhe përgatitjen e projektit për përdorimin eficient të energjisë.
2. Forconi bashkëpunimin vertikal me vendimmarrësit rreth politikës së Eficiencës së Energjisë në shkallë kombëtare. Në të njëjtën kohë forconi bashkëpunimin horizontal mes institucioneve kompetente në zonën tuaj.
- » koordinoni aktivitetet tuaja dhe bashkëpunoni sistematikisht me strukturat e autoriteteve qendrore, në mënyrë që të përmbushni detyrimet tuaja në kohë për të planifikuar në mënyrë strategjike zbatimin e politikave të përshtatura në shkallë kombëtare dhe të bashkoheni me projektet rajonale dhe evropiane. Në të njëjtën kohë, loboni në mënyrë aktive për interesat tuaja përkundrejt vendimmarrësve në shkallë kombëtare,
 - » nxisni koordinimin midis institucioneve përgjegjëse për problemet e politikës së energjisë në zonën tuaj, si dhe organizatat e shoqërisë civile. Ngrini një grup pune që përbëhet nga ekspertë të Eficiencës së Energjisë dhe organizata të shoqërisë civile dhe përcaktoni koordinatorin e grupit. Nëpërmjet takimeve dhe konsultimeve grupi i punës do përcaktojë masat, burimet financiare dhe kohën e zbatimit të politikave, ndërsa koordinatori do të jetë përgjegjës për zbatimin e masave në kohën e duhur.
 - » përshtateni zbatimin vendor të Planit Kombëtar të Veprimit me situatën dhe nevojat e komunitetit tuaj lokal.
3. Përfshijini qytetarët si partnerë gjatë krijimit të programit.
- » organizoni evenimente publike, diskutime, takime pune dhe përfshijini qytetarët në mënyrë që të përcaktoni nevojat dhe mundësitë e tyre. Evente të tilla mund të jenë forumet e energjisë, diskutime me qytetarët gjatë javës së energjisë, debate të hapura në këshillin bashkiak , anketa të qytetarëve, debate të hapura të keshillit bashkiak apo në materiale promovionale, të cilat duhet të jenë të kujdesshme ndaj gjithëpërfshirjes gjinore si dhe të shmangin përdorimin e stereotipeve.
 - » informoni qytetarët rreth përparësive të Eficiencës së Energjisë, specifikisht rreth mundësive të përfitimit të mbështetjes financiare dhe kursimeve potenciale.
4. Vlerësoni të gjitha burimet financiare të nevojshme, si dhe burimet e financimit të të gjitha masave të politikës së re:

- » planifikoni fondet nga buxheti lokal/rajonat për bashkëfinancimin e masave të Efiçencës së Energjisë për sektorin e banesave (izolimin termik, instalimin e paneleve diellore etj) duke patur parasysh rëndësinë e zbatimit të këtyre masave në politika të tjera (politika sociale, burimet e energjisë së rinovueshme, transportit publik, prokurimit publik, koncensioneve etj) dhe gjithashtu duke patur parasysh kapacitetet në dispozicion (një mase e zbatuar me sukses është më mirë se një dizinë të mbetura në letër),
- » planifikoni dhe përgatisni aplikime për projektet e financuara nga institucionet kombëtare që bashkëfinancojnë zbatimin e masave të Efiçencës së Energjisë,
- » planifikoni dhe përgatisni aplikime për projektet e financuara nga Bashkimi Evropian (kini parasysh pajtueshmërinë e tyre me politikat publike, më qëllim rritjen e rezultateve).

Shembull:

Një praktikë pozitive e ndjekur nga bashkitë e Korçës dhe Pogradecit si dhe Manastirit dhe Kërçovës, është partneriteti i tyre në projektin ndërkufitar IPA "Iniciativa për rritjen e dialogut publik për përdorimin e qëndrueshëm të energjisë", financuar nga BE dhe zbatuar nga Akademia e Studimeve Politike në Shqipëri dhe Qendra për Kërkime dhe Politikëbërjen në Maqedoni. Nëpërmjet këtij projekti, u bë e mundur ngritja e një Platforme të Përbashkët Rajonale Veprimi në fushën e përdorimit të energjisë. Autoritetet vendore në katër rajonet e përfshira në këtë projekt përfituan rritjen e mëtejshme të njohurive të stafit të tyre si dhe eksperiencë në organizimin e dialogut publik për shumë çështje të tjera, duke u mbështetur nga kapacitetet e ASP dhe CRPM për të sjellë së bashku drejtues të rëndësishëm lokalë dhe ekspertë profesionistë, aktivistë civilë dhe përfaqësues të medias.

Këshilla dhe rekomandime për zbatimin e politikës

1. Përcaktoni se cilat institucione janë përgjegjëse për zbatimin e instrumentave të politikës; shmangni paqartësitë dhe mbivendosjen e përgjegjëseve.
2. Përdorni të gjitha burimet në dispozicion për të financuar masat e Efiçencës së Energjisë:
 - » nëse nevojitet përdorni eksperte të jashtëm për të trajnuar punonjësit tuaj që të përgatiten dhe aplikojnë me projekte

të Eficiencës së Energjisë tek fondet e BE-së (përfshire dhe ekspertet të organizatave të shoqërisë civile)

3. Mësoni prej shembujve të praktikës së mirë të qyteteve të tjera evropiane:
 - » praktikoni shembuj të qyteteve të tjera evropiane, ashtu si dhe mundësitë për të bashkëpunuar dhe ndarë eksperiencat (binjakëzimin e qyteteve, ngritjen e kapaciteteve njerëzore nëpërmjet binjakëzimit etj)
4. Siguroni një zyrë ose person kontakti për qytetarët (këshillues energjie/qendra informimi energjie) të cilët mund të jenë të arritshëm nga qytetarët për pyetjet rreth Eficiencës së Energjisë në shtëpitë e tyre.
5. Përpiquni të përfshini kompani lokale në projekte të Eficiencës së Energjisë në mënyrë që të mbështetet sipërmarrja vendore dhe të përmirësohen kushtet e jetesës në komunitetin tuaj.

Këshilla dhe rekomandime për vlerësimin dhe monitorimin e politikës

1. Përcaktoni tregues të saktë dhe të matshëm për çdo masë së politikës publike, nëpërmjet së cilës do të monitorohet ndikimi i saj.
2. Monitoroni ndikimin e planifikuar dhe pasojat që sjell çdo masë dhe parapërcaktoni mënyrat për të minimizuar /eliminuar të papriturat.
3. Mbani parasysh raportimin e rregullt të institucioneve përgjegjëse kombëtare si dhe kërkoni të njëjtën gjë për institucionet rajonale / vendore që ndërlidhen me ju.

Shembull:

Në dhjetor 2014 Bashkia e Tiranës, prezantoi "Planin e veprimeve për energjinë e qëndrueshme të Tiranës", një dokument i hartuar me synimin e fotografimit të situatës energjitike të kryeqytetit si dhe përcaktimit të objektivave përkatëse për përmirësimin e saj. Ky plan u hartua me ndihmën e donatorëve të huaj (GIZ dhe PNUD), por ndodhet tashmë në fazën e diskutimeve me ekspertët dhe shoqërinë civile përpara se të marrë aprovimin nga Këshilli Bashkiak dhe të finalizohet. Plani i energjisë, është gjithashtu një mundësi e mëtejshme për të siguruar një ndihmë të fokusuar të donatorëve ndaj planeve zhvillimore të strukturave vendore.

2.3. Këshilla dhe rekomandime për organizatat e shoqërisë civile

Organizatat e Shoqërisë Civile (OJF) janë aktorët kryesorë në krijimin, miratimin dhe zbatimin e politikave publike, edhe pse influenca e tyre mbi politikat nuk është aq domethënëse sa ndikimi i tyre shoqëror. Përfaqësuesit e OJF-ve duhet të jenë të përfshirë në aktivitetin e autoriteteve publike dhe vendore, të marrin pjesë në grupet e punës për zhvillimin e akteve ligjore ose politikave në përgjithësi dhe të jenë antarë në bordet drejtuese ose mbikëqyrëse të institucioneve publike.

Sic u përmend më sipër, në spektrin e pjesëmarrjes publike (tabela 1) qëllimi i veprimit duhet të jetë ngritja e një partneriteti (psh. me një ministri ose autoritet vendor). Kur arrihet realizimi i këtij niveli partneriteti, OJF-të dhe përfaqësuesit e tjerë të interesit publik bashkëpunojnë me sukses duke u garantuar atyre pavarësinë dhe të drejtën për të menduar dhe vepruar në mënyrë aktive, publike dhe kritike, si dhe për të zbatuar fushata lobimi. Partneriteti mund të përfshijë aktivitete sic janë delegimi i detyrimeve specifike mbështetëse të OJF-ve ose detyrave që janë komplementare me politikën duke mundësuar shërbime të interesave publike dhe diskutimeve publike si dhe krijimin e strukturave në vendimarrje të përbashkët mes publikes dhe shoqërisë civile, të cilat në këtë rast përfshijnë edhe mundësinë për bashkëfinancim. Suksesi i këtij partneriteti është besimi dhe bashkëpunimi i ndërsjellë mes partnerëve.

OJF-të duhe t'iu bëjnë të ditur aktorëve të tjerë rëndësinë e përfshirjes së publikut në proceset e politikave publike, por gjithashtu të shërbejnë si shembuj të praktikës së mirë të transparencës së procedurave.

Përfaqësuesit e OJF-ve mund të gjejnë këshilla të ndryshme si të përmirësojnë proceset e pjesëmarrjes publike dhe përfshirjen e aktorëve të tjerë, gjithashtu si të sigurojnë transparencën ndaj krijimit të një politike publike të re.

Shembull:

Çështjet e Eficiencës së Energjisë nuk trajtohen gjerësisht dhe në mënyrë profesionale në Mediat vendase. Kjo edhe për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit të gazetarëve dhe publikut të gjerë ndaj përfitimeve ekonomike dhe zhvillimore që sjell përdorimi i masave të eficiencës. Akademia e Studimeve Politike (ASP) ka organizuar një sërë trajnimesh certifikuese për gazetarët që mbulojnë sektorin e ekonomisë në Mediat e shkruara dhe ato vizive, me synim rritjen e njohurive të tyre në këtë fushë. Gjithashtu, një dokumentar i shkurtër promovues dhe një sërë artikujsh informues mbi eficiencën e energjisë janë përgatitur në kuadër të projektit të dialogut publik mbi energjinë.

Këshilla dhe rekomandime për krijimin dhe miratimin e politikave publike:

1. Përcaktoni rekomandime për politikat publike të reja ose nevojën për rinovimin e atyre ekzistuese:
 - » në rast se konstatooni se ka problematika në fushën e organizatës suaj, të papërfshira në aktet ligjore ekzistuese p.sh. nevoja për të zhvilluar ose rinovuar dokumente strategjike publike në lidhje me këtë fushë, dërgoni një rekomandim tek institucionet qendrore apo ato vendore përgjegjëse për krijimin e kësaj strategjie, legjisllacioni apo rregullore; përpikuni të jeni sa më të saktë dhe të arkikuluar.
 - » vlerësoni burimet tuaja (personelin e disponueshem, financat dhe kohën) dhe kompetencat e nevojshme për pjesëmarrjen në krijimin e një politike publike të re:
 - I. tregoni një shembull të praktikës së mirë duke formuar një grup ekspertësh të fushave të ndryshme dhe duke bashkëpunuar me aktorë të tjerë të përshtatshëm.
 - II. në rast se keni burime të kufizuara për pjesëmarrjen, përdorni rrjetet ekzistuese të OJF-ve ose lidhjet tuaja me OJF-të aktive në krijimin e politikave për të treguar rekomandimet tuaja.
 - » rrisni njohuritë tuaja mbi temën nëpërmjet analizave të detajuara të shembujve të qyteteve të tjera nëpërmjet konsultimeve me ekspertët vendorë.
2. Nxisni ose organizoni një debat publik rreth rekomandimit të politikës publike:
 - » mbani në mendje afatet e vendosura për organizimin e diskutimeve dhe bëhuni pjesë e tyre në kohë.
 - » organizoni një takim me përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse për politikat publike të rekomanduara.
 - I. në rast se një diskutim publik është parashikuar, jepni kontributin tuaj duke përhapur informacionin dhe duke dërguar ftesa për pjesëmarrjen në këtë diskutim.
 - II. në rast se institucioni përgjegjës nuk planifikon të organizojë një diskutim publik:
 1. denonconi publikisht këtë shkelje
 2. ofroni ndihmë për të organizuar një diskutim publik
 3. nisni në kohë iniciativën për diskutimin.

4. në rast se keni mundësinë, merreni përsipër organizimin e diskutimit,
 - » njoftoni Median rreth rekomandimeve mbi politikën e re dhe për ecurinë e diskutimit publik.
 - » mblidhni komentet e qytetarëve rreth rekomandimit të politikës se re, përmbledhni ato në një material dhe dërgojini tek institucionet përkatëse.
 - » publikoni në faqen tuaj të internetit të gjitha informacionet rreth hapave dhe veprimeve që keni marre duke patur parasysh se të gjitha njoftimet duhet të marrin parasysh edhe barazinë gjinore.
3. Loboni për rekomandimet tuaja me personat që kanë kompetenca në propozimin e politikave ose problemeve në lidhje me politikën në ministri, parlament ose institucione të tjera:
 - » nëpërmjet lidhjeve të vendosura më parë me këta individë ose,
 - » nëpërmjet identifikimit të individeve të përshtatshëm.
4. Monitoroni procedurën e miratimit të një politike të rekomanduar.
 - » në rast se vëreni shkelje në procedurë ose gjatë kohës së miratimit të një politike të rekomanduar:
 - I. tërhiqni vëmendjen e institucionit përgjegjës për shkeljen.
 - II. në rast se institucioni përgjegjës nuk e rregullon shkeljen atëherë tërhiqni vëmendjen e publikut nëpërmjet Medias.

Shembull:

Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka hartuar dy projektligje të reja në fushën e Efiçencës së Energjisë, përkatësisht ligjin e Efiçencës dhe ligjin e performancës së ngrohjes së banesave. Pas konstatimit se këto dy projekte ishin hartuar pa përfshirjen e shoqërisë civile, Akademia e Studimeve Politike (ASP) organizoi në dhjetor 2014 në Tiranë një diskutim të hapur me pjesëmarrjen e 15 OJF-ve mjedisore. Ky event u bë i mundur në kuadër të programit të financuar nga DBU "Forcimi i rolit të OJF-ve në dialogun publik për mbrojtjen e klimës në Evropën Juglindore". Falë këtij aktiviteti, aktorët e shoqërisë civile u njohën me dy ligjet si dhe patën mundësinë të ofronin ekspertizën e tyre mbi dokumentet e përgatitura. Gjithashtu, një seancë dëgjimore parlamentare me prezencën e këtyre përfaqësuesve të shoqërisë civile është planifikuar të organizohet në momentin që projektligjet do të diskutohen në komisione.

Këshilla dhe rekomandime për zbatimin e politikës:

1. Monitoroni zbatimin e politikave të miratuara:
 - » duke analizuar çdo herë nëse qëllimet e vendosura janë plotësuar,
 - » duke analizuar nëse strukturat zbatuese përputhen me aktet ligjore.
2. Tërhiqni vëmendjen ndaj të gjitha shkeljeve të dukshme në zbatimin e politikës:
 - » tërhiqni vëmendjen tek institucioni shkelës përgjegjës,
 - » në rast se institucioni përgjegjës nuk e rregullon shkeljen atëherë tërhiqni vëmendjen e publikut nëpërmjet Medias.
3. Komunikoni dhe bashkëpunoni me autoritete lokale dhe rajonale, institucionet zbatuese rajonale dhe vendore dhe aktorë të tjerë të interesuar në zbatimin e politikës:
 - » informojini ata rreth përgjegjësive të tyre,
 - » kërkoni një raport të rregullt kundrejt publikut rreth zbatimit të politikës,
 - » ofroni forma të ndryshme bashkëpunimi dhe ndihmë në zbatimin e politikës.
4. Jini të informuar rreth shembujve të praktikës së mirë dhe ndani informacion rreth tyre.

Këshilla dhe rekomandime për mbikqyrjen e politikë

1. Mbikqyrni raportimet rreth zbatimit dhe ndikimeve të masave të politikës, dhe, në rast se vëreni shkelje, dërgoni ankesa tek institucionet përkatëse:
 - » nxirrni në pah detyrimin e tyre për të informuar publikun rregullisht,
 - » filloni diskutimet me drejtuesit e nivelit të lartë rreth monitorimit dhe zbatimit të politikës.
2. Informohuni rreth shembujve të praktikës së mirë:
 - » kushtojini vëmendje shembujve të mirë të praktikës vendase dhe të huaj.

E përkrahur nga



Sponsored by



www.dbu.de

Partnerët



